



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:227822  
Datë: 14.02.2024  
Numri i dokumentit: 05329620

Ac.nr.6169/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj - kryetar i kolegjit, Faton Ademi dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M. Sh., nga fshati R., Komuna e Vitisë, të cilin e përfaqëson Burim Islami, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës S. J. nga Kllokoti, për shkak të vërtetimit të pronësisë, duke vendosur sipas ankesës së M. I. nga Vitia, rr. “Kongresi i Manastirit”, pa nr. e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit e Kosovës në Prishtinë, CN.nr.12/2020 datës 28.04.2021, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 08.02.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

APROVOHET ankesa e M. I. nga Vitia, NDRYSHOHET aktvendimi i të Gjykatës së Apelit e Kosovës në Prishtinë, CN.nr.12/2020 datës 28.04.2021, ashtu që Hedhet poshtë propozimi për përsëritjen e procedurës i parashtruar nga M. I. nga Vitia, rr. “K. i M.”, pa nr, i datës 26.12.2019, kundër aktgjykimit të gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Viti, C.nr. 166/2018 i datës 04.10.2019.

**A r s y e t i m**

Gjykata e Apelit e Kosovës, sipas gjyqtarit individual, me aktvendimin e atakuar, CN.nr.12/2020 datës 28.04.2021, ka vendosur: REFUZOHET si i pathemeltë propozimi për përsëritjen e procedurës të paraqitur nga M. I. nga Vitia, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil, C.nr.166/2018, i datës 04.10.2019.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë M. I. nga Vitia, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i ankimuar ashtu që të lejohet përsëritja e procedurës, apo të njëjtin ta prishë dhe çështjen ta kthej në ri procedurë dhe ri vendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës të nenit 240 paragraf 4 e lidhur me nenin 194 dhe 208, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e M. I. është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit M. Sh. nga fshati R., Komuna e Vitisë, kundër të paditurës J. S. nga Klllokoti, për shkak të vërtetimit të pronësisë, me aktgjykim C.nr.166/2018, i datës 04.10.2019, ka vendosur që të: Aprovohet kërkesëpadia e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, i cili aktgjykim është bërë i plotfuqishëm me datë 28.10.2019.

Kundër aktgjykimit të shkallës së parë, M. I. nga Vitia, ka paraqitur propozim për përsëritjen e procedurës C.nr.166/2018, i datës 04.10.2019, për shkak të paraqitjeve të provave të reja në kuptim të nenit 232 par. 1 pika a) lidhur me nenin 234 par. 1 pika d), me propozim që të aprovohet si i bazuar propozimi për përsëritjen e procedurës dhe të anulohet aktgjykim i shkallës së parë, me të cilin është aprovuar kërkesë padia e paditësit.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin CN.nr.12/2020 datës 28.04.2021, ka refuzuar si i pathemeltë propozimi për përsëritjen e procedurës të paraqitur nga M. I. nga Vitia, me çka ka vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjyqtari individual i gjykatës së Apelit ka theksuar se Gjykata e Apelit ka vlerësuar pretendimet e propozuesit të paraqitura në propozimin për përsëritje, se kërkesa bazohet në nenin 232 paragrafi 1, pika a) 234 par.1 pika d) të LPK-së, por konsideron se propozimi për përsëritjen e procedurës nuk është i bazuar në asnjërën nga këto dispozita. Në rastin konkret nuk mund të gjejnë zbatim as dispozitat e nenit 232 paragrafi 1, pika a) LPK-së, pasi paragrafi 1, pika a) të nenit 232, përcakton lejimin e procedurës të përfunduar me aktgjykim dhe aktvendim të formës së prere, pika a): “në qoftë se palës me veprim të kundërligjshëm, e sidomos në rast të mos thirrjes për në seancë nuk i jepet mundësia që të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes kryesore”, që në rastin konkret nuk kemi të bëjmë pamundësim të palës për të marrë pjesë në shqyrtim, ngase pala nuk ka qenë palë në procedurë dhe njësia kadastrale (pjesa e pronës) të cilën pretendon së është bashkëpronarë nuk ka qenë objekt kontesti në aktgjykimin e atakuar, andaj gjykata vlerëson se nuk ekzistojnë arsyet ligjore për ta lejuar përsëritjen e procedurës.

Lidhur me mënyrën e vendosjes gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit ju ka referuar nenit 239.1 të LPK- së.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, për të vendosur lidhur me ankesën kundër aktvendimit me të cilin është refuzuar propozimi për përsëritjen e procedurës, bazohet në dispozitën e nenit 240 paragraf 4 të LPK-së, me të cilën është përcaktuar se: “ Lidhur me ankesën kundër aktvendimit me të cilin është refuzuar propozimi për përsëritjen e procedurës, vendos gjykata e shkallës së dytë dhe atë në trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtar ”.

Gjykata e Apelit e Kosovës, nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjyqtarit individual i Gjykatës së Apelit rreth mënyrës se vendosjes nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Përkundër faktit se aktvendimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as me shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, sipas pretendimeve ankimore të palës ankuese. Sipas kësaj gjykate gjendja faktike e konstatuar nga gjyqtari i individual i Gjykatës së Apelit, nuk korrespondon drejtë me provat nga shkresat lëndore. Për pasojë me rastin e vendosjes sipas aktvendimit të atakuar, ka pasur zbatimin e gabuar të së drejtës materiale. Gjykata e Apelit duke shqyrtuar ankesën brenda kufijve të paraqitur nga ankuesi në ankesë e duke u kujdesur për zbatimin e së drejtës materiale sipas detyrës zyrtare ka konstatuar se gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit me rastin e shqyrtimit të propozimit për përsëritjen e procedurës të ushtruar nga M. I. nga Vitia, është dashur ta hedhë poshtë si të pa lejuar dhe jo të vendos për themelësinë e tije.

Gjykata e Apelit duke analizuar propozimin për përsëritjen e procedurës, të ushtruar nga M. M. I. nga Vitia, konstaton se ky propozim është i pa lejuar pasi që i njëjti është ushtruar nga personi i pa autorizuar dhe si të tillë duhet të hedhet poshtë në kuptim të nenit 239. 1 lidhur me nenin 196 dhe 221 të LPK-së, pasi që është ushtruar nga personi i cili nuk ka qenë palë në procedurën e udhëhequr sipas padisë së paditësit M. Sh. nga fshati R., Komuna e Vitisë, kundër të paditurës J. S. nga Kllokoti, për shkak të vërtetimit të pronësisë, e cila procedurë ka përfunduar me aktgjykim C.nr.166/2018, i datës 04.10.2019, i cili është bërë i formës së prerë me datë 28.10.2019. Sipas nenit 232 paragraf 1 pika LPK-së, me të cilën përcaktohet se: *“Procedura e përfunduar me aktgjykim dhe aktvendim të formës së prerë të gjykatës mund të përsëritet sipas propozimit të palës”*. Në rastin konkret parashtuesi i propozimit për përsëritjen e procedurës nuk është palë në procedurë dhe se i njëjti nuk ka autorizim të parashtroj një propozim të tillë, pasi që në kuptim të kësaj dispozite të drejtën për parashtimin e propozimit për përsëritjen e procedurës kanë vetëm palët në procedurën e cila ka përfunduar me vendim të plotfuqishëm.

Andaj gjykata e Apelit duke u bazuar sipas nenit 239.1 të LPK-së, i cili parasheh që *“Gjykata e shkallës së dytë vendosë mbi propozimin për përsëritjen e procedurës zakonisht jashtë seance për shqyrtim kryesor”*, ndërsa sipas nenit 196 i LPK-së, i cili zbatohet përshtatshëmish edhe për procedurën për përsëritjen e procedurës, i cili parasheh që *“Ankesën e vonuar, jo të plotë, apo jo të lejueshme, e hedhë poshtë gjykata e shkallës së dytë me aktvendim, po që se nuk e ka bërë një gjë të tillë gjykata e shkallës siç parashikuar (në nenin 186)”*, ndërsa sipas nenit 221 të LPK-së i cili po ashtu zbatohet përshtatshëmish edhe për procedurën për përsëritjen e procedurës i cili parasheh që *“Revizionin e vonuar, jo të plotë dhe të palejueshëm me, aktvendim e hedhë poshtë gjykata e revizionit, po që se një gjë të tillë nuk e ka bërë gjykata e shkallës së parë brenda kufijve të autorizimeve të saja (neni 218 i këtij ligji)”*, ndërsa pasi që me nenin 237 të LPK-së është paraparë që *“Propozimin për përsëritjen e procedurës të paraqitur pas afatit ligjor, atë jo të plotë, apo të palejueshëm, e hedhë poshtë gjykata e shkallës së parë me anë të aktvendimit pa mbajtur seancë gjyqësore”*. Andaj, me qenë se gjykata e shkallës së parë edhe gjyqtari Individual i Gjykatës së Apelit, nuk kanë vepruar në kuptim të kësaj dispozite, kolegji i gjykatës së Apelit vlerëson se propozimi për përsëritjen e procedurës duhet që fillimisht të vlerësohet në kuptim të lejueshmërisë së tije, ashtu që pas vlerësimi të të njëjtit konstatohet se i njëjti është i pa lejuar dhe

si i tillë duhet të hedhet poshtë, pasi që është ushtruar nga personi i pa autorizuar. Gjykata e Apelit konsideron se parashtruesi i propozimit për përsëritjen e procedurës, në lidhje me pretendimet e tije mund të inicioj procedurë tjetër, me qëllim të realizimit të kërkesave të tij, por jo në këtë procedurë sipas propozimit për përsëritjen e procedurës.

Andaj, nga të cekurat si më lartë, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin nenit 208, 196 dhe 221 lidhur me nenin 237 , lidhur me nenin 240, të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
Ac.nr.6196/21, me datë 07.02.2024

Kryetari i kolegjit, Gjyqtari  
Besnik Bisliraj, d.v